



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.139-2/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada Gllogjani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjeti Ballkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, dhe duke vepruar sipas udhëzimeve që kanë rezultuar nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A.A-U.ZH.nr.10/2019 i datës 04.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa A.nr.139/2019 e datës 30.09.2019, e paraqitur nga organizata Rrjeti Ballkanik për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Rregullën Zgjedhore nr.20/2019, nenin mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së – përfshirja e fëmijëve nën moshën 15 vjeqare, në fushatën zgjedhore, i shqiptohet denimi gjorbë në lartësi prej 6,300.00 (gjashtë mijë e treqind) euro, të cilën gjorbë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Urdhërohet subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që brenda afatit prej 24 orëve, nga pranimi i këtij vendimi, ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 30.09.2019, me të cilën pretendon se nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës Blerand Stavileci, me datën 29.09.2019 rreth orës 20.00 në profilin e tij në Facebook, ka publikuar një fotografi me fëmijët e tij të cilët mbajnë veshur bluzat me numrin zyrtar të PDK, në këto zgjedhje. Paraqitësi i ankesës pretendon se me këtë Blerand Stavileci, nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka shkelur rregulloren zgjedhore 20/2019 neni 5 paragrafi 3 pika d). Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 01.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK, thekson se Blerand Stavileci anëtar i kësaj partie ka vendosur në profilin e tij në Facebook, foton familjare për të cilën foto theksojn se fotografia nuk është bërë në asnjë

takim fushate nga subjekti në fjal por në shtëpin e tij dhe se nuk përmban as një shkelje të rregullave zgjedhore respektivisht me asgjë nuk e cenon nenin 2 të Rregullës Zgjedhore nr. 20/2019.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën shkresat tjera të lëndës, vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotoja e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se nënkryetari Blernad Stavileci, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, nëpërmjet rrjetit të tij Facebook, ka postuar një fotografi me fëmijet e tij të cilët mbajnë të veshura bluzat, me numrat e Partisë Demokratike të Kosovës, në këto zgjedhje, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet, nenin 5.3 e Riformaluar pika b), c), d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së , që në rastin konkret, fëmijët nën 18 vjet, kanë të veshura bluzat me emrin e Partisë Demokratike të Kosovës dhe numrin e kësaj partie.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin e tyre se në foton e bashkangjitur shihen fëmijët e nënkryetarit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, foto kjo e cila është bërë në shtëpinë e tij. Fëmijët nuk kanë qenë të përdorur për fushatë, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që fotografia e fëmijëve nuk është hequr nga faqja zyrtare në Facebook. Duke marrë për bazë faktin se fëmijët të cilët janë ekspozuar në foto përmbajnë materiale propagandistike, dhe se fotoja është publikuar në rrjetin social, pamarrë parasysh faktin se fëmijët janë të nënkryetarit të subjektit në fjalë, e po ashtu pamarrë parasysh faktin se ambienti ku është bërë fotografia është ambient familjar-shtëpia e

personit ën fjalë, me vet faktin se kjo foto është publikuar në rrjet social dhe kanë pasur mundësinë edhe të tjerët të shikojnë këtë foto, kjo është në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore nr.20/2019, nenin mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së nenin 5.3 e Riformoluar pika b), c), d), pra përbën shkelje. Meqenëse subjekti në fjalë përveq që ka mohuar shkeljen, nuk ka ndërmarr veprime përmirësuese për të larguar fotografinë, kjo ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me këtë gjob paneli vlerëson se do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Në raport me pikën II të dispozitivit të vendimit, Paneli vendosi që konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së, të urdhëron subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljen në afatin prej 24 orëve, ndërsa në të kundërtën nëse nuk vepron sipas urdhrat të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.139-2/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuese e Panelit

Faton Adem



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimat të këtij vendimi.